



Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave  
me Aftësi të Kufizuar

## **Guidë shpjeguese mbi**

### **LIGJIN**

**Nr.7889, date 14.12.1994**

**ndryshuar me Ligjin 8052 date 21.12.1995,**

**Ligjin 9143 date 16.10.2003**

## **PER STATUSIN E INVALIDIT TE PUNES**

Financuar nga "Komiteti Suedez i Helsinkit  
për të Drejtat e Njeriut"

Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

Nëntor 2005

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar  
Adresa: Rruga "Mujo Ulqinaku" Nr. 26 Tiranë  
Tel: 003554 266 892/269 426  
E-mail: [adrf@icc.eu.org](mailto:adrf@icc.eu.org)  
[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

Financuar nga "Komiteti Suedez i Helsinkit  
për të Drejtat e Njeriut"

Swedish Helsinki Committee  
for Human Rights

## Përmbajtja

Kush e përfiton statusin e invalidit .....	7
Kush përfiton shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit .....	9
Dokumentat për të përfituar shtesën mujore mbi pensionin e invaliditetit .....	11
A vazhdojnë shtesat mujore mbi pensionin e invaliditetit edhe pas daljes në pension? .....	13
Invalidët që janë të punësuar .....	15
Si veprohet në ato raste kur KMCAV vendos për ndryshimin e grupit të invaliditetit etj .....	15
Invalidët e Punës që komisionohen për herë të parë? .....	16
A mund ta përfitoj pagësën e invaliditetit në rast se komisionohem me vonesë? .....	16
Ku tërhiqet pagesa e pensionit të invaliditetit dhe shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit .....	16
Si do të veprohet në ato raste kur invalidi ka ndryshuar vendbanimin e tij .....	16
Kofidencialitetit .....	17
Me mbushjen e moshës për pension apo daljen në pension, a mund ta përfitoj Statusin e Invalidit të Punës? .....	17
Mjetet dhe pajisjet e invalidëve që siguron ISSH, kriteret dhe administrimi i tyre .....	17
Mjetet dhe pajisjet që sigurohen nga vetë invalidët dhe çlirimi nga detyrimi doganor .....	18
Dokumentacioni që paraqitet nga invalidët në DRSSH (Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore) .....	18
Procedura e pajisjes së invalidit me mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme .....	19

Kriteret e përfitimit të pajisjeve të ndryshme dhe mjeteve lëvizëse motorrike .....	20
Kush përfiton rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve? .....	21
Rimbursimi i biletave në nivel urban dhe interurban .....	22
Pjesmarrja në aktivitetet kulturore, sportive, artistike etj .....	22
Shërbimi mjekësor .....	23
E drejta për informim .....	23
Punësimi i Invalidëve të Punës .....	23
Stimujt për inkurajimin e punësimit të personave që gëzojnë statusin e invalidit të punës .....	24
A është e tatueshme paga e invalidëve të punës? .....	24
Taksat e drejtëpërdrejta, nga të cilat përjashtohen personat me statusin e invalidit të punës .....	24
Kur personi i cili gëzon statusin e invalidit të punës ushtron veprimtari private, përjashtohet nga taksat? .....	25
E drejta e ankimimit në gjykatë .....	26
Roli i Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të Punës .....	26
Marrja pjesë e shoqatave që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar në vendimarrje, diskutim dhe miratim ligjesh .....	26
Ligji Nr.7889, date 14.12.1994“Per Statusin e Invalidit te Punes” dhe aktet në zbatim të tij .....	27

## Hyrje

Në këtë guidë udhëzuese është trajtuar **Ligji Nr.7889, date 14.12.1994“Per Statusin e Invalidit te Punes”**, ndryshuar me Ligjin 8052 date 21.12.1995 dhe Ligjin 9143 date 16.10.2003.

Ky botim, i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar pason guidat shpjeguese mbi legjislacionin Shqiptar të fokusuar mbi Aftësinë e Kufizuar.

Duke patur në konsideratë kërkesat e vazhdueshme të Shoqatave dhe Personave me Aftësi të Kufizuar, për sqarimin e ligjeve më të rëndësishme në fushën e AK kësaj here trajtuam Statusin e Invalidit të Punës. Guidat në vazhdim do të pasojnë me shpjegimin e statuseve të tjera si i para-tetraplegjikut, i të verbërit dhe Ligjit për Ndhimë dhe Shërbime Shoqërore.

Duke shpresuar se do ti vijmë sadopak në ndihmë PAK dhe familjarëve të tyre, një falenderim të veçantë i kushtojmë Donatorit “Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut”.

---

Shënim: Gjithçka që është shpjeguar në këtë guidë nuk ka fuqi ligjore dhe asgjë në këtë guidë nuk zëvendëson kërkesat e ligjit.

***Guidë shpjeguese mbi***  
**LIGJIN**  
**Nr.7889, date 14.12.1994**  
**ndryshuar me Ligjin 8052 date 21.12.1995, Ligjin 9143 date**  
**16.10.2003**  
***PER STATUSIN E INVALIDIT TE PUNES***

## **Kush e përfiton Statusin e Invalidit të Punës?**

*Statusin e invalidit të punës e përfiton:*

- personi i aksidentuar ne pune,  
*apo*
- i semure nga semundje profesionale,  
*apo*
- semundje te ndryshme  
*dhe*
- që përfiton pension invaliditeti nga Sistemi i Sigurimeve Shoqerore, sipas ligjit nr. 4171, date 13.9.1966 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar), ligji nr. 4976, date 29.6.1972 "Per pensionin e ish-anetareve te kooperativave bujqesore" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 7703, date

11.5.1993“Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise”  
(i ndryshuar)”

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Mbi sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” trajton me pensione invaliditeti personat që janë bërë të paaftë plotësisht ose pjesërisht, gjatë periudhës së sigurimit, për shkak të një aksidenti në punë, sëmundjeve profesionale ose të përgjithshme.

Bazuar në ligjin Nr.7889, date 14.12.1994 ndryshuar me Ligjin 8052 date 21.12.1995 dhe Ligjin 9143 date 16.10.2003“Per statusin e invalidit te punes”

Përfitojnë shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit (në masa të ndryshme), këto 2 kategori :

**1. Kategoria e parë, të gjithë ata invalidë pune të cilët kanë përfituar pension invaliditetit bazuar në sistemin e sigurimeve shoqërore, pra të ligjit nr. 7703, date 11.5.1993 “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise” (i ndryshuar); rregulluar me VKM 204 datë 16.04.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës”**

**2. Kategoria e dytë, të gjithë ata invalidë të cilët e kanë fituar statusin e invalidit të punës pas daljes të ligjit Nr.7889, date 14.12.1994 “Per statusin e invalidit te punes” (i ndryshuar), rregulluar me VKM 381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar).**

**Shënim:** Për të qënë më të qartë, në fund të guidës do të gjeni të gjithë legjislacionin që rregullon “Statusin e Invalidit të Punës”.

Më konkretisht:

### **1. Në kategorinë e parë, të cilët përfitojnë shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, përfshihen;**

#### **a. Te gjithë ata invalid pune**

- të cilët kanë qene te punesuar në ndermarrjet, institucionet shtetërore,
- ish-kooperativat bujqësore,
- repartet ushtarake,
- ushtarët e shërbimit të detyrueshëm,
- që vuajne nga semundje profesionale, ose jane te aksidentuar ne pune apo kane semundje te ndryshme,
- dhe që marrin pension invaliditeti bazuar në sistemin e sigurimeve shoqërore (ne mbeshtetje te ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993“Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise”, të ndryshuar ose të ligjit 4976 datë 29.06.1972“Për pensionet e ish-antarëve të kooperativave bujqësore” të ndryshuar) dhe **VKM 204 datë 16.04.2004** “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës”.

**b.** Te gjithë ata persona te cilet kane qene invalide pune deri ne momentin e mbushtjes se moshes per pension dhe qe kane dale ne pension pleqeriqe;

**c.** Te gjithë ata invalide pune qe jane deklaruar invalide pergjithmone.

Percaktimi i invalideve te punes që do të përfitojnë këtë shtesë behet nga Drejtoria e Rajonale e Sigurimeve Shoqerore.

Kategoritë e përmendura më sipër (a, b, c) do të përfitojë shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, si perfitim paaftesie, në këto masa:

<b>Personat qe perfitojne pension invaliditeti te plote</b>	<b>3000 leke</b>
<b>Personat qe perfitojne pension invaliditeti te pjesshem</b>	<b>2000 leke</b>

Shtesa u jepet invalideve te punes pavarësisht nga te ardhurat e tjera qe ata perfitojne nga programet e mbrojtjes sociale dhe nuk llogaritet në të ardhurat e familjes. Ajo perfitohet edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqerie.

Referuar Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, kjo kategori përfiton pension invaliditeti në këto masa:

### **Invalidi i plotë perfiton çdo muaj :**

#### **a. Nga nje semundje e pergjithshme,**

-masa e pensionit	<b>7266 leke</b>
-5% te pensionit baze per cdo femije ne ngarkim, por jo me shume se 20% sipas ligjit Nr.7703 dt11.05.1993 (neni 39)	<b>1120 leke</b>
-kompesim per nje person ne ngarkim	<b>414 leke</b>
-kompesim per energjiine elektrike	<b>350 leke</b>
- per ndryshimin e çmimit te bukes	<b>150 leke</b>
- <b>shtesë paaftesie siaps VKM 204, dt 16.04.2004</b>	<b>3000 leke</b>
gjithsej	<b>12.3000 leke</b>

#### **b. Nga nje semundje profesionale apo aksident, 12.300 lek**

**c. Per invalidetin e plote nga nje semundje e pergjithshme qe ka nevoje per perkujdesje** invalidi perfiton .

-masa e pensionit	<b>7266 leke</b>
-shtese per perkujdesje e	<b>1600 leke</b>
-kompesim per femijet ne ngarkim	<b>1120 leke</b>
-kompesim per nje person ne ngarkim sipas VKM 310dt 24.04.1992	<b>414 leke</b>
-kompesim per energjiine	<b>350 leke</b>
-kompesim per cmimin e bukes	<b>150 leke</b>
-shtese sipas VKM 204	<b>3000 leke</b>
<b>Shuma</b>	<b><u>13.900</u> leke</b>

### **Per invaliditetin e pjesshem**

a. Per invaliditetin e pjesshem nga semundje te pergjithshme (gr IV), invalidi perfiton sipas neni 37 keto te ardhura :

masa e pensionit	<b>3633 leke</b>
kompesimi i energjiise	<b>350 leke</b>
kompesimi i cmimit te bukes	<b>150 leke</b>
nje person ne ngarkim	<b>414 leke</b>
<b>Shuma</b>	<b>4547 leke</b>

### **b. Per invaliditetin e pjesshem si rezultat i nje aksidenti e semundje profesionale ne pune,**

invalidi perfiton edhe nje shtese sipas VKM 204 dt 16.04.2004	<b>2000 leke</b>
<b>Shuma</b>	<b>6547 leke</b>

## **2. Në kategorinë e dytë që përfitojnë shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit përfshihen;**

### **Invalidet, që kanë qenë të punësuar:**

- në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore
- ish-kooperativat bujqësore
- dhe janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë

- dhe që përfitojnë sipas VKM 381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar), pra kanë përfituar pensionin e invaliditetit pas miratimit të Statusit të Invalidit (viti 1994)

Sipas VKM 381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar), shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit ishte;

- **2150 lek**, për invalidët që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme të një personi tjetër.
- **1900 lek** për invalidët që janë plotësisht të paaftë për punë.
- **1645 lek**, për invalidët që janë pjesërisht të aftë për punë.
- **1500 lek** për invalidët me sëmundje të përgjithshme

Bazuar në **Udhëzimin 682/6 datë 7.09.2004 (i ndryshuar)** kjo kategori do të përfitojë shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit të barabartë me diferencën, ndërmjet masave të parashikuara në VKM 204 datë 16.04.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës” dhe masave të përcaktuara në VKM 381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar), pra:

Për personat me invaliditet të plotë të cilët përfitojnë sipas VKM nr. 381 datë 20.05.1996, shtesa e pagesës është në masën;

**850 lek në muaj**, për invalidët që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme të një personi tjetër.

**3000 – 2150 = 850 lek (invalid i plotë),**

**1100 lek në muaj**, për invalidët që janë plotësisht të paaftë për punë.

**3000 – 1900 = 1100 lek (i paaftë plotësisht për punë),**

**355 lek në muaj**, për invalidët që janë pjesërisht të aftë për punë.  
**2000 – 1645 = 355 lek (invalid i pjesshëm)**

#### **Shembull:**

X gëzon Statusin e invalidit të punës (invalid i plotë, plotësisht i paaftë për punë) dhe përfiton në bazë të VKM 381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar).

Shtesa mujore që do të përfitojë ai në këtë rast është sa diferenca e masës të përcaktuar në VKM 204 datë 16.04.2004 dhe masës të parashikuar në VKM 381 datë 20.05.1996, pra

$3000 - 1900 = 1100 \text{ lek}$

shtesa mujore që do të përfitojë X mbi pensionin e invaliditetit në këtë rast do të jetë **1100 lek**

### ***Referuar Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, kjo kategori përfiton pension invaliditeti në këto masa:***

#### **Invalidi i plotë perfiton çdo muaj :**

##### **a. Nga nje semundje e pergjithshme,**

- masa e pensionit	<b>7266</b> leke
- 5% te pensionit baze per cdo femije ne ngarkim, por jo me shume se 20% sipas ligjit Nr.7703 dt11.05.1993 (neni 39)	<b>1120</b> leke
- kompesim per nje person ne ngarkim	<b>414</b> leke
- kompesim per energjiene elektrike	<b>350</b> leke
- per ndryshimin e cmimit te bukes	<b>150</b> leke
gjithsej	<u>9300</u> leke

<b>b.Nga nje semundje profesionale apo aksident, nje shtese sipas VKM 381,</b>	<b>2150 leke</b> 11 450 leke
--	---------------------------------

**c.Per invalidetin e plote nga nje semundje e pergjithshme qe ka nevojë per perkujdesje invalidi perfiton .**

-masa e pensionit	<b>7266 leke</b>
-shtese per perkujdesje e	<b>1600 leke</b>
-kompesim per femijet ne ngarkim	<b>1120 leke</b>
-kompesim per nje person ne ngarkim sipas VKM 310dt 24.04.1992	<b>414 leke</b>
-kompesim per energjine	<b>350 leke</b>
-kompesim per cmimin e bukes	<b>150 leke</b>
-shtese sipas VKM 381	<b>1897 leke</b>
<b>Shuma</b>	<b><u>12797 leke</u></b>

Per invaliditetin e pjesshem

**a.Per invaliditetin e pjesshem nga semundje te pergjithshme (gr IV),**

invalidi perfiton sipas neni 37 keto te ardhura :

masa e pensionit	<b>3633 leke</b>
kompesimi i energjise	<b>350 leke</b>
kompesimi i cmimit te bukes	<b>150 leke</b>
nje person ne ngarkim	<b>414 leke</b>
<b>Shuma</b>	<b>4547 leke</b>

**b.Per invaliditetin e pjesshem si rezultat e nje aksidenti e semundje profesionale ne pune,**

invalidi perfiton edhe nje shtese sipas VKM 381 dt 20.05.1996	1644 leke
<b>Shuma</b>	<b>6191 leke</b>

**Personat të cilët pretendojne te perfitojne shtesen e pageses si invalid pune duhet te paraqesin çdo vit ne zyrat e njesise se pushtetit vendor keto dokumenta:**

- Kerkesë të invalidit të punës per trajtim me shtesën mujore;
- Çertifikate personale me fotografi;
- Kopje e noterizuar e Deshmise se Invalidit të Punes;
- Vertetimi mjekesor i leshuar nga KMCAP-i me vulen e njome ku te jete percaktuar grupi i invaliditetit.

A vazhdojnë shtesat mujore mbi pensionin e invaliditetit edhe pas daljes në pension?

Po, shtesat mujore mbi pensionin e invaliditetit vazhdojnë edhe kur personi që gëzon statusin e individit del në pension.

### ***Invalidët që janë të punësuar***

Per invalidet qe jane të punësuar dhe do te merret vendim i ri nga KMCAP-ja, periudha e perfitimit do te jete nje vjecare dhe me pas per cdo vit rikomisionimi.

**Si veprohet në ato raste kur KMCAP vendos për :**

- ndryshimin e grupit te invaliditetit nga invalid i plote ne invaliditet te pjesshem;
- ndryshimin e grupit te invaliditetit nga i pjesshem ne te plote;
- heqjen e te drejtes se perfitimit nga statusi i invalidit te punes etj?

Në këto raste ndryshimi i mases se perfitimit te shteses per shkak te aftesisë te kufizuar do te behet ne muajin pasardhes, (nje muaj pas komisionimit).



## ***Personat që komisionohen për herë të parë***

Per personat qe Komisionohen per here te pare dhe perfitojne Statusin e Invalidit te Punes, pagesa e paaftesise mbi shtesen e pensionit te invaliditetit fillon ne muajin pasardhes nga data e daljes ne KMCAP.

### ***A mund ta përfitojë pagesën e invaliditetit në rast se komisionohem me vonesë?***

Në rastet kur invalidi i punës për shkaqe që nuk varen nga ai, është komisionuar me vonesë, ka qënë i sëmurë , për kurim brenda dhe jashtë vendit dhe kjo kohë argumentohet me dokumentacion vërtetues, invalidi gëzon të drejtën e përfitimit të pagesës *deri në tre muaj vonese.*

### ***Ku tërhiqet pagesa e pensionit të invaliditetit dhe shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit?***

Pagesa terhiqet nga personi i cili gëzon statusin e invalidit të punës çdo muaj prane arkes se njesise se pushtetit vendor ku ka vendbanimin, duke paraqitur dokumentin e identifikimit.

### ***Në ato rase kur invalidi ka ndryshuar vendbanimin e tij, si do të veprohet?***

Kur invalidi ka ndryshuar vendbanimin e tij dhe dosjen e invaliditetit e ka ne vendbanimin e meparshem, pagesa ne vendbanimin e ri do te filloje pas transferimit te dosjes nga njesia e qeverisjes vendore te meparshme.

## ***Kofidencialitetit***

Asnje organ nuk ka te drejte te jape te dhena per gjendjen e invaliditetit te nje personi që gëzon statusin e invalidit të punës pa pelqimin tij.

### ***Me mbushjen e moshës për pension apo daljen në pension, a mund ta përfitoj Statusin e Invalidit të Punës?***

Po, Statusi i invalidit vazhdon edhe pas mbushjes se moshes per pension pleqerie. Çdo person ka të drejtë të zgjedhë midis pensionit të invaliditeti apo të pleqërisë duke gjykuar se kush është më i favorshmi për të.

### ***Mjetet dhe pajisjet e invalidëve që siguron ISSH, kriteret dhe administrimi i tyre:***

Instituti i Sigurimeve Shoqerore administron pajisjen e invalideve me :

- a) mjete levizese, perfshi autovetura dhe pajisje te ndryshme ortopedike.
- b) me mjete ndihmese degjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmese kardiake

Instituti të Sigurimeve Shoqerore i akordohet çdo vit nga buxheti i shtetit një fond në lekë për blerjen e mjeteve të lartpërmendura.

### ***Mjetet dhe pajisjet që sigurohen nga vetë invalidët dhe çlirimi nga detyrimi doganor:***

Kur individi i siguron vetë pajisjet apo mjetet lëvizëse dhe kërkon të çlirohen nga detyrimi doganor do të ndiqen këto procedura:

1. kërkesa e personit i cili gëzon statusin e invalidit dhe dokumentacioni i pronësisë apo pajisjes së mjetit përcillen zyrtarisht në ISSH nga Drejtoria e përgjithshme e Doganave
2. kërkesa rregjistrohet dhe shqyrtohet brenda një muaji nga dorëzimi i saj së bashku me të gjitha dokumentat e nevojshëm. Afati pezullohet kur dokumentat kthehen për arsye të përligjura nga dispozitat ligjore apo rregulloret e posaçme. Për çdo rast bëhet shënimi përkatës në rregjistër.
3. ISSH nëpërmjet organeve të specializuara shqyrton dokumentacionin e dërguar dhe i përgjigjet zyrtarisht Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave, nëse invalidi plotëson kushtet për tu pajisur ose jo.
4. kriteret e përfitimit, dokumentacioni dhe procedura janë të njëjta me ato që përcaktohen më poshtë.

### ***Dokumentacioni që paraqitet nga invalidët në DRSSH (Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore)***

1. kërkesë personale,
2. çertifikatë lindjeje me fotografi (e vlefshme brenda muajit),
3. dëshmi aftësie (për invalidët që kanë nevojë për mjete lëvizëse motorike),
4. dokumenta të pronësisë së mjetit (akt blerje apo dhurimi të mjetit nga pronari, hartuar sipas kërkesave të kodit civil),

5. vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për hyrjen e automjetit,
6. dokumentacioni i mjetit.

### ***Procedura e pajisjes së invalidit me mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme:***

1. KMCAPI i DRSSH-së mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, në gjendjen shëndetësore të invalidit dhe kriteret e përfitimit merr vendim të posaçëm nëpërmjet të cilit rekomandon pajisjen e invalidit.
2. Vendimi i KMCAPI –it konfirmohet (miratohet) nga Drejtori i DRSSH –së nëpërmjet urdhërit të tij.
3. Dokumentacioni i inventarizuar së bashku me dosjen e pensionit të invaliditetit dërgohet zyrtarisht në ISSH.
4. Dosja e invalidit shqyrtohet në ISSH nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.
5. Komisioni mbështetur në dokumentacionin e dërguar merr vendimin përkatës (për raste të veçanta mund të kërkojë edhe ekspertimin e invalidit nga KMCAPI –i Epror) të cilin ja paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së.
6. Për rastet që invalidi, për shkak të llojit dhe shkallës të paaftësisë, nuk mund të drejtojë vetë automjetin, ai paraqet një prokurë të posaçme, të noterizuar, me të cilin autorizon për të drejtuar mjetin e tij një pjestar tjetër i familjes. Kur nuk ka pjestar të familjes, me prokurë si më sipër, mund të autorizojë një të afërm. Në këtë rast paraqet edhe një çertifikatë familjare si dhe dëshminë e aftësië për drejtimin e mjetit.
7. Invalidi përfitues paraqitet në DRSSH ku nënshkruan një kontratë me Drejtorinë e DRSSH –së (bashkalidhur kontrata).

### ***Kriteret e përfitimit të pajisjeve të ndryshme dhe mjeteve lëvizëse motorrike:***

1. Mjete lëvizëse të thjeshta përfitojnë invalidët me gjendje shëndetësore që nuk lejon lëvizjen (ecjen) pavarësisht nga origjina e kësaj gjendjeje shëndetësore.
2. Mjetet ndihmëse kardiake (PACE-MAKER) përfitojnë invalidët kartiopatë me patologji të ritmit (sipas rekomandimit të klinikës kardiologjike).
3. Mjetet ndihmëse dëgjimore e pamore, përfitojnë invalidët me probleme të dëgjimit e të pamjes (sipas rekomandimit të klinikave përkatëse).
4. Pajisje të ndryshme ortopedike përfitojnë invalidët me fraktura të ekstremiteteve inferiore, coxarthroza, amputacione.

### ***Mjete lëvizëse motorrike përfitojnë:***

- a) Invalidët e aksidentuar në punë me trauma të kolonës vertebrale me pasojë paraplegji inferiore,
- b) invalidët e aksidentuar në punë me amputacion të një ekstremiteti inferjor,
- c) invalidët e aksidentuar në punë me amputacion të dy ekstremiteteve inferiore,
- d) invalidë me gjendje shëndetësore si a,b,c, rrjedhojë e një traume jashtë pune ose sëmundjeje të përgjithshme,
- e) invalidët në pamundësi definitive për lëvizje (ecje) të pavarur, pavarësisht nga origjina e kësaj gjendjeje shëndetësore.

Nëse invalidi ka patur një mjet për të cilin është çliruar nga dogana, mund të çlirohet nga dogana për një mjet tjetër kur

vërtetohet nga organet kompetente se mjeti i mëparshëm ka dalë jashtë përdorimit.

### ***Kush përfiton rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve?***

- Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, invalidet që kanë mjete motorrike për invalidet si dhe për invalidët e tjerë që nuk percaktohen si invalidë pune në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", por që për arsye riaftesimi janë pajisur nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore me mjete motorrike, para vitit 1994.
- E drejta e invalideve për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe lubrifikanteve, percaktohet në vendimet e lëshuara nga KMCAP (komisjonet mjeksore të caktimit të aftësisë për punë), pranë ISSH dhe organeve rajonale në varesi të tij.
- Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 4 000 leke.
- Pagesa e shumave mujore të rimbursimit të shpenzimeve, për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve, realizohet çdo muaj, nga zyrat e sigurimeve shoqerore, me paraqitjen e librezës së invaliditetit dhe të vërtetimit të posacem, lëshuar nga KMCAP (komisjonet mjeksore të caktimit të aftësisë për punë) si përdorues i mjetit të përshtatur.

### ***Rimbursimi i biletave në nivel urban dhe interurban***

Udhëtimi i personave të cilët gëzojnë statusin e invalidit me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas është **falas**.

Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat nderqytetas është me **50 përqind e vlerës së biletës**.

Të gjitha mjetet e udhëtimit qytetas dhe ndërqytetas rezervojnë vende të veçanta për invalidet.

### ***Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore, sportive, artistike etj***

Te gjithë invalidet që gezojnë zyrtarisht statusin e invalidit të punës në bazë të ligjit, kanë të drejtë të hyjnë në të gjitha llojet e institucionet buxhetore e jo buxhetore, për të gjitha llojet e veprimtarive kulturore e artistike, rinore e sportive, që zhvillohen në mjedise publike, të hapura ose të mbyllura. Hyrja e invalideve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 përqind të çmimit të biletës. Invalidi në momentin e prerjes të biletës duhet të paraqesë dokumentin identifikues që e njeh zyrtarisht si të tillë.

Për pjesëmarrjen e invalideve në veprimtari të tilla, institucionet janë të detyruara të rezervojnë për ta vende të përshtatshme. Personeli i shërbimit të institucionit ku zhvillohet veprimtaria, duhet ta ndihmojë Invalidin pa asnjë lloj shpërblimi, për të siguruar atij qëndrimin sa më normal në institucion, gjatë kohës të zgjatjes të veprimtarisë.

Invalidet favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit profesional që zhvillojnë institucionet e sistemit të kultures, rinise dhe sporteve. Mjediset që institucionet shtetërore të sistemit të kultures, rinise dhe sporteve vihen në përdorim pa shpërblim në

dispozicion të Shoqatës së Invalideve të Punës për të zhvilluar veprimtarinë e tyre.

### ***Shërbimi mjekësor***

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk levizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas.

Rimbursimi i barnave realizohet në masën 100%.

Mjediset e institucioneve shëndetsore, të perkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga personat me aftësi të kufizuara.

### ***E drejta për informim***

Te drejtat që gezojnë invalidet sipas statusit të tyre, afishohen në vende të dukshme në mjediset publike.

### ***Punësimi i Invalideve të Punës***

Ndalohet çdo lloj diskriminimi (për shkak të racës, seksit, fesë, moshës, të metave fizike apo mendore) në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit.

Invalidet punësohen dhe ripunësohen në ndërmarrje shtetërore dhe private në procese pune të përshtatshme që rekomandohen nga KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë).

Ndalohen të punojnë në punën e natës punëmarrësit e deklaruar invalidë mbi bazën e raportit mjekësor sipas ligjit për sigurimet shoqërore.

### ***Stimujt për inkurajimin e punësimit të personave që gëzojnë statusin e invalidit të punës***

Punëdhënësi mund të kërkojë subvencion nga zyra kompetente e punësimit për të pajisur si duhet vendin e punës të punëmarrësit me statusin e invalidit të punës.

Një punëdhënësi i cili nuk punëson numrin e kërkuar të personave me aftësi të kufizuar (në çdo 24 punonjës, 1 duhet të jetë me AK) është i detyruar të paguajë në një llogari të veçantë të Fondit Kombëtar të Punësimit shumën e barabartë me minimumin e pagës për çdo muaj dhe çdo PAK që ai duhet të kishte punësuar. Këto të ardhura krijohen për të krijuar vende pune për PAK.

### ***A është e tatueshme paga e invalidëve të punës?***

Paga që një punëdhënësi i paguan një personi me aftësi të kufizuar që ai punëson përjashtohet nga taksat deri në një masë të caktuar me Vendim të Këshilli të Ministrave.

### ***Taksat e drejtëpërdrejta, nga të cilat përjashtohen personat me statusin e invalidit të punës, janë:***

- **Taksat për shërbimet konsullore** (përjashtimi nga taksat për shërbimet konsullore bëhet në rastet e pajisjes të invalidit të punës me pasaportë).
- **Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti** (përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, në rastet e pajisjes me dëshmi aftësie për drejtim automjeti)
- **Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive**

(përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, kur këto pajisje janë në emrin e tyre).

- **Taksa për përdorimin e numrit telefonikë kabllor** (përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, kur abonimi telefonik është në emrin e tyre)
- **Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë** (përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, në rastet kur dëshirojnë të vazhdojnë arsimin e lartë)
- **Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion** (përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, kur kalojnë kufirin e Republikës të Shqipërisë me avion)
- **Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi** (përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës, në rastet e pajisjes me pasaportë lundrimi)

Përjashtimi nga pagimi i taksave të drejtëpërdrejta bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të invalidit të punës.

Invalidi i punës duhet të paraqesi pranë Agjendit Tatimor librezën e invalidit të punës së bashku me dokumentin që e ka pajisur dega e tatimeve të rrethit për përjashtimin nga këto taksa.

### ***Kur personi i cili gëzon statusin e invalidit të punës ushtron veprimtari private, përjashtohet nga taksat?***

Personi i cili gëzon statusin e invalidit të punës ushtron veprimtari private, nuk përjashtohet nga sistemi i taksave dhe tatimeve.

Veprimtaria e tij ekonomike është e tatueshme në masë të njëjtë me atë të subjekteve të tjera private.

## ***E drejta e ankimimit në gjykatë***

Per shkelje te drejtave qe sanksionohen nga Ligji për "Statusin e Invalidit të Punës", invalidi ka te drejte t'i drejtohet gjykates, individualisht ose nepermjet shoqatave qe mbrojne interesat e tyre.

## ***Roli i Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të Punës***

Shoqata e Invalidëve të Punës ka statusin e Shoqatës Kombëtare. Ajo ka degët e saj në çdo qytet të Shqipërisë. Çdo person që caktohet me vendim të KMCAP invalid, duhet të pajiset me dëshmi zyrtare identifikimi nga Shoqata e Invalidëve të Punës në mënyrë që të gëzojë përfitimet të cilat burojnë nga ligji.

Shoqata e Invalidëve të Punës paraqet çdo tre muaj pranë Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror një kopje të listave të Invalidëve të Punës që përfitojnë shtesën mujore mbi pensionin e invaliditetit.

Shteti financon veprimtarine e Shoqates se Invalideve te Punes sipas mundesive dhe burimeve financiare te planifikuara per kete qellim.

Mjediset qe shteti ve ne dispozicion te Shoqates se Invalideve te Punes per te zhvilluar veprimtarine e saj, jepen ne perdorim pa shperblim.

## ***Pjesmarrja e shoqatave që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar në vendimarrje, diskutim dhe miratim ligjesh***

Shoqatat qe mbrojne interesat e invalideve, marrin pjese ne mbledhjet per diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nenligjore qe prekin drejteperdrejte a terthorazi interesat e nevojat e invalideve.

Gjate pergatitjes se akteve ligjore e nenligjore dhe te programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalideve.

## **LIGJ**

**Nr.7889, date 14.12.1994**

***Ndryshuar me***

**Ligjin 8052 date 21.12.1995**

**Ligjin 9143 date 16.10.2003**

## **PER STATUSIN E INVALIDIT TE PUNES**

***Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim te Keshillit te Ministrave,***

KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Statusin e invalidit e gezon personi i aksidentuar ne pune, i semure nga semundje profesionale ose semundje te ndryshme, qe perfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqerore, sipas ligjit nr. 4171, date 13.9.1966 "Per sigurimet shoqerore ne

Republiken e Shqipërisë, i ndryshuar, ligji nr. 4976, date 29.6.1972 "Per pensionin e ish-anetareve te kooperativave bujqesore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqipërisë" (i ndryshuar).

#### Neni 2

Shoqëria dhe shteti marrin ne mbrojtje invalidet, ne menyre qe ata te marrin pjese ne jeten shoqerore njelloj si te tjeret, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshem per te jetuar ne menyre dinjitoze, te kene kushte banimi, te shfrytezojne mjedisin e jashtem, te kene nje pune te pershtatshme, si dhe t'u krijohen mundesi normale per kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhese e argetuese.

#### Neni 3

Shteti mbron invalidet nga te gjitha llojet e shfrytezimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.

#### Neni 4

Invalidet paisen me deshmi zyrtare identifikimi. Deshmia leshohet nga Shoqata e Invalideve te Punes ne baze te KMCAP.

#### Neni 5

Asnje organ nuk ka te drejte te jape te dhena per gjendjen e invaliditetit te nje personi pa pelqimin tij.

#### Neni 6

Statusi i invalidit vazhdon edhe pas mbushjes se moshes per pension pleqerie.

#### Neni 7

Invalidet e punes, qe kane qene te punesuar ne ndermarrjet, institucionet shteterore, ish-kooperativat bujqesore, repartet ushtarake, si dhe ushtaret e sherbimit te detyrueshem, qe vuajne nga semundje profesionale, te aksidentuar ne pune dhe me semundje te ndryshme, qe marrin pension invaliditeti, ne mbeshetje te ligjit nr.4171, date 13.9.1966 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken Popullore te Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 4976, date 29.6.1972 "Per pensionin e ish-anetareve te kooperativave bujqesore", i ndryshuar dhe ligjit nr. 7703 date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqipërisë" (i ndryshuar), perfitojne nje shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit si perfitim paaftesie nga Buxheti i Shtetit.

Kriteret e marrjes se perfitimit te paaftesise dhe masa e tij percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.

#### Neni 8

8.1 . Instituti i Sigurimeve Shoqerore administron pajisjen e invalideve me :

- a) mjete levizese perfshi edhe autovetura dhe pajisje te ndryshme ortopedike.
- b) me mjete ndihmese degjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmese kardiake etj.

Kriteret percaktohen me rregullore te Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

8.2. Invalidet nuk paguajne taksa doganore per mjetet levizese dhe ndihmese te percaktuara ne pikat a , b dhe c te pikes 8.1 te nenit 8.

#### Neni 9

Ne shtepite ekzistuese te pushimit shteti ne marreveshje me subjektet qe i ka ne pronesi cakton nje kontigjent vendesh per

pushimin e invalideve.

Ne vendet e pershtatshme klimaterike, shteti, cakton sipërfaqe te lira per ndertimin e kampeve te pushimit dhe qendrave te rehabilitimit per invalidet. Rregullat e financimit per ndertimin e tyre vendosen me vendim te Keshillit te Ministrave.

#### Neni 10

Per te paralizuarit dhe te gjymtuarit rende qe nuk levizin, organizohet sherbimi mjeksor ne banese falas.

Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit nxjerr aktet nenligjore perkatese.

#### Neni 11

11.1. Udhetimi i invalideve me mjetet e komunikacionit shteteror dhe privat qytetas behet falas.

11.2. Udhetimi me mjetet e komunikacionit shteteror dhe privat nderqytetas behet me 50 perqind te vleres se biletës.

11.3. Te gjitha mjetet e udhetimit qytetas dhe nderqytetas rezervojne vende te vecanta per invalidet.

Ministria qe mbulon transportin dhe komunikacionin nxjerr aktet nenligjore perkatese.

#### Neni 12

Hyrja e invalideve ne shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive behet me 50 perqind te çmimit te biletës.

Ministria qe mbulon kulturen, rine dhe sportet nxjerr aktet nenligjore perkatese.

#### Neni 13

13.1. Mjediset e institucioneve shendetsore, te perkujdesjes shoqerore dhe ato publike pershtaten per perdorimin e tyre nga te

verbrit dhe paraplegjiket.

Procedurat e fazat e pershtatjes percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.

13.2. Te gjitha ndertimet e reja publike qe realizohen pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, duhet te ofrojne mundesi perdorimi nga kategorite e ndryshme te personave me aftesi te kufizuara.

Ministria qe mbulon ndertimin, strehimin dhe rregullimin e territorit nxjerr aktet nenligjore perkatese.

#### Neni 14

Invalidet punesohen dhe ripunesohen ne ndermarrje shteterore dhe private ne procese pune te pershtatshme qe rekomandohen nga Komisioni Mjeksor i Caktimit te Aftesise per Pune.

Rregullat per punesim dhe ripunesim te invalideve caktohen me ligj te vecante.

#### Neni 15

Invalidet favorizohen ne ndjekjen e kurseve te kualifikimit e te rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave te larta.

#### Neni 16

16.1. Invalidet perjashtohen nga taksat e drejtëpërdrejta te parashikuara ne ligjin nr.7680, date 3.3.1993 "Per sistemin e taksave ne Republiken e Shqiperisë".

16.2. Kur invalidi ushtron veprimtari private, nuk perjashtohet nga taksat.

#### Neni 17

Gjate pergatitjes se akteve ligjore e nenligjore dhe te programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalideve.

Shoqatat qe mbrojne interesat e invalideve, marrin pjese ne



mbledhjet per diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nenligjore qe prekin drejteperdrejte a terthorazi interesat e nevojat e invalideve.

#### Neni 18

18.1. Shteti financon veprimtarine e Shoqates se Invalideve te Punes sipas mundesive dhe burimeve financiare te planifikuara per kete qellim.

18.2. Mjediset qe shteti ve ne dispozicion te Shoqates se Invalideve te Punes per te zhvilluar veprimtarine e saj, jepen ne perdorim pa shperblim.

#### Neni 19

19.1. Te drejtat qe gezojne invalidet sipas statusit te tyre, afishohen ne vende te dukshme ne mjediset publike.

19.2. Per shkelje te te drejtave qe sanksionohen nga ky ligj, invalidi ka te drejte t'i drejtohet gjykates, individualisht ose nepermjet shoqatave qe mbrojne interesat e tyre.

#### Neni 20

20.1. Per zbatimin e ketij ligji ngarkohet Ministria e Punes, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

20.2. Ministrite dhe institucionet e tjera qendrore perkatese nxjerrin aktet nenligjore te percaktuara me kete ligj brenda 90 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

#### Neni 21

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

## **V E N D I M**

**Nr.199, date 3.5.1995**

## **PER LEHTESITE QE U KRIJOHEN INVALIDEVE NE NDERTIMET PUBLIKE**

***Ne zbatim te ligjit nr.7889, date 14.12.1994 "Per statusin e invalidit" me propozimin e Ministrise se Ndertimit dhe Turizmit, Keshilli i Ministrave***

### **V E N D O S I:**

**1.** Te gjitha ndertime e reja publike qe realizohen pas hyrjes ne fuqi te ligjit Nr.7889, date 14.12.1994 " Per statusin e invalidit" dhe te ketij vendimi duhet te ofrojne kushte te pershtatshem perdorimi dhe per invalidet, qe menjanojne barrierat arkitektonike.

**2.** Te gjithë personat fizike e juridike qe hartojne projekte per ndertime publike (spitale, shtepi pushimi dhe shkolla), ne mjediset e jashtme te ketyre ndertimeve parashikojne kushte qe mbajne parasysh interesat e invalideve dhe te personave me aftesi te kufizuara.

**3.** Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ministria e Ndertimit

dhe e Turizmit, Ministria e Punes, Emigracionit, Perkrahes Sociale dhe ish -te Perndjekurve Politike, si dhe gjithe institucionet projektuese e zbatuese publike e private.

4. Llojet dhe kategorite e barrierave arkitektonike do te percaktohen me udhezim te vecante te Ministrise se Ndertimit dhe Turizmit.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

## **VENDIM**

**Nr.612, date 6 .11.1995**

# **PER FAVORIZIMIN E INVALIDEVE NE SISTEMIN E KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE**

***Ne mbeshtetje te ligjit nr.7889, date 14.12.1994  
"Per statusin e invalidit", me propozimin e Ministrise se Kultures,  
te Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave***

## **VENDOSI:**

**1.** Te gjithe invalidet qe gezojne zyrtarisht statusin si te tille, ne baze te ligjit te siperpermendur, kane te drejte te hyjne ne te gjitha llojet e institucionet buxhetore e jo buxhetore, per te gjitha llojet e veprimtarive kulturore e artistike, rinore e sportive, qe zhvillohen ne mjedise publike, te hapura ose te mbyllura.

**2.** Institucionet e permendura ne piken 1 te ketij vendimi, ne nivel kombetar e lokal, jane te detyruara te pranojne ne çdo rast ata invalide qe paraqesin deshmine e invalidit per te gjitha veprimtarite, kundrejt pageses prej 50 perqind te cmimit te biletetes, te vendosur

per ate shfaqje ose veprimtari.

Invalidi, ne momentin e prerjes se biletas duhet te paraqese dokumentin identifikues qe e njeh zyrtarisht si te tille, sic parashikohet ne ligjin Nr.7889, date 14.12.1994 "Per statusin e invalidit".

**3.** Per pjesmarrjen e invalideve ne veprimtari te tilla, institucionet jane te detyruara te rezervojne per ta vende te peshtatshme.

**4.** Personeli i sherbimit te institucionit ku zhvillohet veprimtaria, duhet ta ndihmojne Invalidin pa asnje lloj shperblimi, per t'i siguruar atij nje qendrim sa me normal ne institucion, gjate kohes se zgjatjes se veprimtarise.

**5.** Invalidet te favorizohen ne ndjekjen e kurseve te kualifikimit profesional qe zhvillojne institucionet e sistemit te kultures, rinise dhe sporteve.

**6.** Mjediset qe institucionet shtetere te sistemit te kultures, rinise dhe sporteve vene ne dispozicion te Shoqates se Invalideve per te zhvilluar veprimtarine e tyre, vihen ne perdorim pa shperblim.

**7.** Efekti financiar qe rrjedh nga shitja e biletave me 50 per qind te cmimit, te perballohet nga te ardhurat e vet institucionit.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

## **V E N D I M**

**Nr.381, datë 20.5.1996 ndryshuar me**

**VKM nr .385, date 14.7.2000**

**VKM nr. 437 datë 26.6.2003**

## **PER ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATE 14.12.1994 "PER STATUSIN E INVALIDIT"**

***Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave***

## **V E N D O S I:**

**1.** Në zbatim të neneve 1 dhe 2 të ligjit nr.7889, date 14.12.1994 "Për statusin e invalidit";invalidi për të përfutuar shtesën mujore mbi pension, të paraqesë pranë Drejtorisë së sigurimeve shoqërore të rrethit përkatës, librezën e pensionit të invaliditetit.

**2.** Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit":

a) Invalidëve që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore dhe janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie ne masen:

- **2150 lek**, për invalidët që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme të një personi tjetër.

- **1900 lek** për invalidët që janë plotësisht të paaftë për punë.

- **1645 lek**, për invalidët që janë pjesërisht të aftë për punë.

b) Paraplegjikët dhe të paralizuarit që përfitojnë pension të plotë pleqërie, marrin përfitim mbi pensionin e invaliditetit në masën 1500 lekë në muaj.

c) Invalidët nga sëmundjet e përgjithshme, që përfitojnë pension dhe që kanë nevojë për shërbim, marrin përfitim paaftësie mbi pensionin e invaliditetit në masën 1500 lekë në muaj.

**3.** Shtesat e parashikuara në gërmat a, b dhe c vazhdojnë edhe kur invalidi del në pension pleqërie.

Për periudhën maj 1995 deri më 30 qershor 1996 në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, shtohen 71 milionë lekë të cilat përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punën publike.

Efektet financiare të periudhës korrik-dhjetor 1996 do të financohen nga Këshilli i Ministrave në fund të vitit sipas shpenzimeve faktike.

**4.** Në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", Institutit të Sigurimeve Shoqërore i akordohet çdo vit nga buxheti i shtetit një fond në lekë për blerjen:

a) e mjeteve lëvizëse dhe të pajisjeve të ndryshme ortopedike;

b) e mjeteve ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;

c) e mjeteve ndihmëse kardiake etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 1.5.1995.

## REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI I MINISTRAVE

### VENDIM

N r. 204 date 16.4.2004

PER

## Masen dhe kriteret per perfitim paaftesie nga personat me statusin e invalidit te punes

*Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 7, te ligjit nr.7889, date 14.12.1994, "Per Statusin e Invalidit", te ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave*

VENDOSI:

**1.** Invalidet e punes, te cilet kane qene te punesuar ne ndermarrjet, ne institucionet shteterore, ish-kooperativat bujqesore, repartet ushtarake, si dhe ushtaret e sherbimit te detyrueshem, qe vuajne nga semundje profesionale a jane te aksidentuar ne pune apo kane semundje te ndryshme, e qe marrin pension invaliditeti,

ne mbeshtetje te ligjit nr.7703, date 11.5.1993, "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shgiperise" (te ndryshuar), ose te ligjit nr.4976, date 29.6.1972, "Per pensionin e ish-anetareve te kooperativave bujqesore",te ndryshuar,perfitojne nje shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit,si perfitim paaftesie,nga fondi i pageses se personave me aftesi te kufizuar,si me poshte vijon:

- |  |                  |
|--|------------------|
| a) Personat qe perfitojne pension invaliditeti te plote    | <b>3000 leke</b> |
| b) Personat qe perfitojne pension invaliditeti te pjesshem | <b>2000 leke</b> |

**2.** Invalidet,te cilet perfitojne sipas shkronjave "a","b",e "c",te pikes 2 te vendimit nr 381, date 20.5.1996, te Keshillite Ministrave, "Per zbatimin e ligjit nr. 7889, date 14.12.1994, "Per Statusin e Invalidit", te ndryshuar, perfitojne nje shtese mujore te barabarte me diferencen, ndermjet mases se percaktuar ne piken 1, te ketij vendimi si perfitim paaftesie dhe te perfitimit te percaktuar ne vendimin nr.381 date 20.5.1996 te Keshillit te Ministrave.

**3.** Kjo shtese u jepet invalideve te punes pavaresisht nga te ardhurat e tjera qe ata perfitojne nga programet e mbrojtjes sociale dhe nuk llogaritet ne te ardhurat e familjes.Ajo perfitohet edhe pas mbushjes se moshes per pension pleqerie.

**4.** Organet e sigurimeve shoqerore dergojne zyrtarisht kopje te vertetimeve te KMCAP-it per paaftesine ne pune,listen e perfituesve dhe masen e perfitimit, sipas vendimit nr.381, date 20.5.1996, te Keshillit te Ministrave, prane Zyrrave Rajonale te Sherbimit Social Shteteror. Keto zyra pergatisin listen e perfituesve dhe urdherpagesen, te cilat i dergojne ne zyrrat e njesive te pushtetit vendor, ku invalidet kane vendbanimin.

**5.** Instituti i Sigurimeve Shoqerore pergatit vertetimin tip te KMCAP-it per paaftesine ne pune, te parashikuar ne piken 4 të ketij vendimi.

**6.** Pagesa terhiqet nga invalidi cdo muaj prane zyrrave te njesive te pushtetit vendor, duke paraqitur dokumentin e identifikimit.

**7.** Ngarkohet Ministri i Punes dhe i Ceshtjeve Sociale te nxjerre udhezimin ne zbatim te ketij vendimi.

**8.** Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punes dhe i Ceshtjeve Sociale per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shkurt 2004

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Ministria e Punës dhe Ceshtjeve Sociale**

**UDHEZIM**

**Nr 682/4 date 18.06.04.**

***Ndryshuar me udhëzimin 682/6 datë 7.09.2004***

**PER MASEN DHE KRITERET PER PERFITIM  
E PAAFTESISE NGA PERSONAT  
ME STATUSIN E INVALIDIT TE PUNES**

***Ne mbeshetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne zbatim te pikes 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr 204, date 16.04.2004 "Per masen dhe kriteret per perfitim paaftesie nga personat me statusin e invalidit te punes"***

**UDHEZOJ:**

**1.** Invalidet e punes qe perfitojne sipas pikes 1, te VKM Nr 204 date 16.04.2004, "Per masen dhe kriteret per perfitim paaftesie nga

personat me statusin e invalidit te punes" do te marrin nje shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, si perfitim per paaftesine e tyre nga fondi i pageses se personave me aftesi te kufizuar.

Kete shtese mujore e perfitojne:

**1-a.** Te gjithë ata invalid pune qe marrin aktualisht pension invaliditeti sipas dispozitave te ligjit "Per sigurimet shoqerore" sipas pikes 1 te vendimit Nr.204 dt 16.04.2004.

**1-b.** Te gjithë ata persona te cilet kane qene invalide pune deri ne momentin e mbushtjes se moshes per pension dhe qe kane dale ne pension pleqerie;

**1-c.** Te gjithë ata invalide pune qe jane deklaruar invalide pergjithmone.

**2.** Percaktimi i invalideve te punes sipas pikes 1-a, 1-b, 1-c te ketij Udhëzimi behet nga Drejtoria e Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te cilet leshojne vertetimin per Invaliditetin e plote, vertetim per Invaliditetin e pjesshem dhe vertetimin per Invalidet qe sot perfitojne pension pleqerie, sipas Mod. Tip qe i bashkelidhet ketij Udhëzimi.

**3.** Per invalidet qe jane ne aktivitet dhe do te merret vendim i ri nga KMCAJ ja, periudha e perfitimit do te jete nje vjecare dhe pastaj me pas per çdo vit rikomisionimi.

**4.** Ne rastet kur KMCAJ, vendos per:

- a. ndryshimin e grupit te invaliditetit nga invalid i plote ne invaliditet te pjesshem;
- b. ndryshimin e grupit te invaliditetit nga i pjesshem ne te plote;
- c. heqjen e te drejtes se perfitimit nga statusi i invalidit te punes etj; ndryshimi i mases se perfitimit te shteses per shkak te aftesis te kufizuar do te behet ne muajin pasardhes, (nje muaj pas komisionimit) te percaktuar sipas vertetimit Tip te percaktuar

ne piken e dyte te ketij udhezimi.

**5.** Per personat qe Komisionohen per here te pare dhe perfitejne Statusin e Invaliditetit te Punes, pagesa e paaftesise mbi shtesen e pensionit te invaliditetit fillon ne muajin pasardhes nga data e daljes ne KMCAP te percaktuar sipas Vertetimit Tip.

**6.** Shtesa e pageses per personat me invaliditet te plote te cilet nuk perfitojne sipas VKM Nr 381, date 20.05.1996, i ndryshuar, do te jete 3000 leke ne muaj.

**7.** Per personat me invaliditet te plote te cilet perfitojne sipas pikes 2 te vendimit nr 381, date 20.05.1996, shtesa e pageses do te jete 850 leke ne muaj (3000 -2150) ose 1100 leke ne muaj (3000-1900).

**8.** Shtesa e pageses per personat me invaliditet te pjesshem te cilet nuk perfitojne sipas VKM Nr 381, date 20.05.1996, i ndryshuar, do te jete 2000 leke ne muaj.

**9.** Per personat me invaliditet te pjeshem te cilet perfitojne sipas pikes 2 te vendimit nr 381, date 20.05.1996, shtesa e pageses do te jete 355 leke ne muaj (2000 - 1645 = 355 leke).

**10.** Shtesa e pageses u jepet invalideve te punes, pamvaresisht nga te ardhurat e tjera qe ata perfitojne nga programet e mbrojtjes shoqerore dhe nuk llogariten ne te ardhurat e familjes per efekt te perfitimit te ndihmes ekonomike.

**11.** Drejtorite Rajonale te Sigurimeve Shoqerore do te dergojne prane zyrave rajonale te Sherbimit Social Shteteror nje kopje te vertetimit tip te KMCAP-it per paaftesine ne pune sipas formularit Tip te bashkelidhur ketij Udhezimi.

**12.** Drejtorite Rajonale te Sigurimeve Shoqerore do te dergojne, prane zyrave rajonale te SHSSH listen e perfituesve si dhe masen e shteses se perfitimit nga vendimi nr 381, date 20.05.1996, i ndryshuar, per personat qe perfitojne invaliditet te plote ose te pjesshem.

**13.** Drejtorite Rajonale te Sigurimeve Shoqerore dergojne prane Zyrave Rajonale te Sherbimit Social Shteteror, listen e invalideve perfitues dhe vertetimet qe jane derguar nga ata, sipas pikës 2 të ketij udhezimi, në format zyrtar dhe elektronik. Zyrat Rajonale të Sherbimit Social Shteteror, këtë informacion e dergojne në njësité e qeverisjes vendore.

**14.** Shoqata e Invalideve te Punes cdo tre muaj paraqet prane Njësive të Pushtetit Vendor dhe Zyres Rajonale te Sherbimit Socialë nje kopje te listave te Invalideve te Punes qe perfitojne nga VKM Nr. 2004 dt 16.04.2004.

**15.** Zyra Rajonale e SHSSH perpilon nevojat per fonde në bazë të kërkesave të njësive të qeverisjes vendore dhe i paraqet ato ne Sherbimin Social Shteteror, i cili ben çeljen e tyre ne thesar per çdo komune/bashki

**16.** SHFUQIZOHET

**17.** SHFUQIZOHET

**18.** Keshilli i Bashkise/ Komunes informohet nga administratorët shoqëror për fondin e pagesës së aftesise se kufizuar per invalidet e punes.

**19.** Borderoja per pagesen e aftesise se kufizuar per shkak te invaliditetit te pune perpilohet nga zyra e finances se Bashkise/ Komunes.

**20.** Pagesa terhiqet nga invalidi çdo muaj prane arkës se njesise se pushtetit vendor ku ka vend banimin, duke paraqitur dokumentin e identifikimit.

**21.** Ne rastet kur invalidi i punes per shkaqe qe nuk varen nga ai, eshte komisionuar me vonese, ka qene i semure, per kurim brenda apo jashte vendit dhe kjo kohe argumentohet me dokumentacion vertetues, invalidi gezon te drejten e perfitimit te pagese deri ne tre muaj vonese.

**22.** Administratoret shoqerore te njesise te pushtetit vendor

hapin dosje per cdo invalid pune.

**23.** Personat qe pretendojne te perfitojne shtesen e pageses si invalid pune duhet te paraqesin cdo vit ne zyrat e njesise se pushtetit vendor kete dokumenta:

- Kerkes per trajtim;
- Çertifikate personale me fotografi;
- Kopje e noterizuar e Dëshmise se Invaliditetit te Punes;
- Vertetimi mjekesor i leshuar nga KMCAPI me vulen e njomë ku te jete percaktuar grupi i invaliditetit.

**24.** kur invalidi ka ndryshuar vendbanimin e tij dhe dosjen e invaliditetit e ka në vendbanimin e mëparshëm, pagesa në vendbanimin e ri do të fillojë pas transferimit të dosjes nga njësia e qeverisjes vendore të mëparshme.

**25.** ngarkohet Shërbimi Socila Shtetëror të kontrollojë zbatimin e VKM nr. 204 datë 16.04.2004 dhe Udhëzimit të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale nr. 682/4 datë 18.06.2004.

Ky udhezim hyn ne fuqi pas botimit ne fleteren zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga 1.02.2004.

## Vendim

**Nr. 723 date 19.11.1998**

***Ndryshuar me vendimin nr. 183 dt 15.04.1999***

***Ndryshuar me vendimin Nr.687, date 15.12.2000***

## **Per zbatimin e ligjit 7889 DT 14.12.1994**

### **“Per statusin e invalidit”**

***Ne zbatim te ligjit nr. 7889 dt 14.12.1994 “Per statusin e invalidit”,  
ndryshuar me ligjin nr. 8052 dt 21.12.1995, me propozimin  
e Ministrise te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli I Ministrave***

VENDOSI:

1. Perfitojne rimbursimin e shpenzimeve, per blerjen e karburanteve dhe te lubrifikanteve, invalidet qe kane mjete motorrike per invalidet.

Perfitojne rimbursimin e shpenzimeve, per blerjen e

---

**Shënim:** Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale zëvendësohet me Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta.



karburanteve dhe te lubrifikanteve, edhe ata invalide, qe nuk percaktohen si te tille ne nenin 1, te ligjit nr.7889, date 14.12.1994 "Per statusin e invalidit", por qe per arsye riaftesimi jane pajisur nga Istituti i Sigurimeve Shoqerore me mjete motorike, para vitit 1994.

2. E drejta e invalideve per te perfituar rimbursimin e shpenzimeve, per blerjen e karburanteve dhe lubrifikanteve, percaktohet nga komisjonet mjeksore te caktimit te aftesise per pune, prane ISSH dhe organeve rajonale ne varesi te tij, sipas kritereve te percaktuara nga ky institut.

3. Shuma mujore e rimbursimit te shpenzimeve per blerjen e karburanteve e te lubrifikanteve eshte 4 000 leke.

4. Pagesa e shumave mujore te rimbursimit te shpenzimeve, per blerjen e karburanteve e te lubrifikanteve, te realizohen çdo muaj, nga zyrat e sigurimeve shoqerore ne rrethe, me paraqitjen e librezes se invaliditetit dhe te vertetimit te posacem, leshuar nga komisjonet mjeksore te caktimit te aftesise per pune.

5. Efektet financiare ne masen 8 300 000 leke ne vit, per zbatimin e ketij vendimi, te perballohen nga buxheti i shtetit dhe te programohen çdo vit ne buxhetin e ISSH.

6. Ngarkohet Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe Istituti i Sigurimeve Shoqerore per zbatimin e ketoj vendimi.

7. Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 48 date 14.02.1994 "Per çmimet e shitjes se karburanteve per invalidet tetra dhe paraplegjik" shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.01.1999.